



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të neneve 22, 49 dhe 51 të Ligjit për ndërtim nr. 2004/15, dt. 27.5.2004; të nenit 17, shkronja **d** dhe nenit 40 shkronja **c** e Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03 /L- 040; nenit 16 pika **e** dhe të neneve 29 dhe 51 të Statuti të Komunës së Prishtinës nr. 01-110-455, dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 29.10.2008, merr

V E N D I M
MBI LLOGARITJEN DHE KOMPENSIMIN PËR MBIKËQYRJEN E OBJEKTEVE

Neni 1

1.1 Me këtë Vendim caktohet baza e llogaritjes dhe procedurat për pagesën e kompensimit për punën e mbikëqyrjes profesionale të objekteve në territorin e komunës së Prishtinës, investues i të cilave është Kuvendi i Komunës së Prishtinës, dhe që mbikëqyren nga nëpunësit e Kuvendit të Komunës.

1.2 Në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, do të trajtohen edhe objektet që financohen nga donacionet, të cilat pas realizimit të tyre mbeten në qeverisje të Komunës.

Neni 2

2.1 Mbikëqyrja profesionale e objektit do të kryhet në bazë të nenit 22 të Ligjit për ndërtim nr. 2004/15 dhe përfshin mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve dhe të punëve ndërtimore në përputhje me: Ligjin e planifikimit hapësinor, Ligjin e ndërtimit, Udhëzimet administrative të nxjerra në bazë të Ligjit të ndërtimit dhe të kodeve tjera ekzistuese.

2.2 Mbikëqyrja profesionale do organizohet për objektet për të cilat është dhënë leja e ndërtimit dhe do t'i kryejnë ekspertët që i plotësojnë kriteret e parapara ligjore, të punësuar në organet ekzekutive komunale.

Neni 3

Mbikëqyrësit kanë obligim që mbikëqyrjen ta kryejnë edhe pas orarit të rregullt të punës dhe gjatë fundjavës, varësisht nga nevojat në punishte.

Neni 4

4.1 Kompensimi i mbikëqyrjes do të llogaritet në vlerë si në tabelën e mëposhtme:

Vlera e investimit	50,000 €	200,000 €	500,000 €	900,000 €	3,400,000 €	10,000,000 €	20,000,000 €
		65,000 €	245,000 €	530,000 €	1,000,000 €	3,800,000 €	15,000,000 €
Përqindja	3.50%	2.50%	2.00%	1.90%	1.70%	1.50%	1.00%
Vlera për mbikëqyrje	1,750.00 €	5,000.00 €	10,000.00 €	17,100.00 €	57,800.00 €	150,000.00 €	200,000.00 €
		1,625.00 €	4,900.00 €	10,070.00 €	17,000.00 €	57,000.00 €	150,000.00 €

4.2 Pagesa për punën e organit mbikëqyrës do të përfshihet në vlerën e përgjithshme të investimit.

4.3 Këto vlera të mbikëqyrjes do të vlejné për mbikëqyrje të objekteve që nuk janë investim i Komunës, ndërsa për objektet që investohen nga Komuna e Prishtinës, vlera për pagesë do të jetë e përgjysmuar (30%) nga vlerat e dhëna në tabelën në par. 4.1.

4.4 Pagesa për punën e mbikëqyrjes do të bëhet në xhirollogaritë personale të anëtarëve të mbikëqyrjes, me shpërndarje të vlerave për secilin anëtarë të mbikëqyrjes si më poshtë:

4.5 Menaxheri i projektit do të paguhet 20% më shumë se mbikëqyrja e arkitekturës ose e statikës, mbikëqyrësit e fazave tjera do të paguhen në vlerë prej 0.6 e arkitekturës ose statikës.

Psh. Qx (1.2+1+1+0.6+0.6+0.6)/5 menaxheri	Q/5 x 1.2
Ark. ose stat.	Q/5 x 1
Uji dhe kanal.	Q/5 x 0.6

Q - vlera e mbikëqyrjes,
Ark. - arkitektura,
Stat. - statika.

Neni 5

Shpenzimet për mbikëqyrje do të jenë pjesë e investimit (në paramasën dhe parallogarinë e punimeve), ndërsa mënyra e pagesës do të bëhet në bazë të situacioneve për punët e kryera.

Neni 6

Pagesa e mbikëqyrësve dhe menaxherit të projektit do të bëhet pas nënshkrimit të situacionit për punët e kryera dhe pas raportimit të menaxherit të projektit bërë Drejtorisë së Administratës dhe Personelit, Zyrës së Prokurimit dhe Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Drejtoria e Infrastrukturës Lokale.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01 Nr. 400-1609, më 29.10.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof. dr. Isa Musatafa